



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.13, datë 18.05.2026

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 43,  
DATË 08.11.2024 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS  
KANALIZIME VLORË SH.A”, I NDRYSHUAR.**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (*Ligji nr. 8102*), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (*VKM nr. 958*), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (*Rregullore e licencimit*),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 18.05.2026 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e Vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 43, datë 08.11.2024 "Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë sh.a", i ndryshuar.

**Konstatoi se:**

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë Sh. a me shkresën nr. 1003 prot., datë 09.04.2026, me lëndë "Përcjellje e dokumentacionit për ndryshimin e përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë sh.a", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (*ERRU*) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, e ndryshuar.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (*KKRR*) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë sh.a (*SHRUK Vlorë*) për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, e ndryshuar.

3. KKRR ka licencuar SHRUK Vlorë sh.a me vendimin nr. 43, datë 08.11.2024 “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a”, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e ujërave të ndotura.
4. Drejtues ligjor i shoqërisë me vendimin e KKRR nr. 43, datë 08.11.2024, “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a”, i ndryshuar, ishte z.Ermal Murati, i cili kishte përfunduar studimet Bachelor për Menaxhim Biznesi, viti 2001, në Tiranë në Fakultetin Ekonomik. Në këtë aplikim është zëvendësuar nga z.Klevis Kaso me Master Shkencor në Administrim Biznes, i diplomuar në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, viti 2009. Z. Klevis Kaso ka një eksperiencë disa vjeçare në pozicione drejtuese dhe menaxheriale, si në sektorin privat ashtu dhe në sektorin publik. Gjatë periudhës 2023-2025 ka qenë zëvendëskryetar i bashkisë Vlorë.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958, dhe Rregullores së Licencimit, e ndryshuar, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa SHRUK Vlorë sh.a është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Gërma a, e pikës 2, e vendimit të KKRR-së nr. 43, datë 08.11.2024 “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a”, i ndryshuar, bëhet si më poshtë:

*a) Drejtues Ligjor - z. Klevis Kaso*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**Gerta Lubonja**